




KOMUNA E PODUJEVËS

DRAFT PROGRAMI TREVJEÇAR I BANIMIT

2026-2028



LLOJI I DOKUMENTIT: PROGRAMI KOMUNAL PËR BANIM 2026-2028

ZYRA E KRYETARIT TE KOMUNËS

VENDIMI: 02-020/04-0008157/26 i datës 05.02.2026

**GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E PROGRAMIT TREVJEÇAR TË BANIMIT NË KOMUNËN E
PODUJEVËS**

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Drejtoria	Përgjegjësia në Komision
1	Blerina Zeka	Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit	Kryesuese
2	Arbresha Bashota	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	Anëtare
3	Florie Humolli	Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë	Anëtare

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
QËLLIMI.....	5
VIZIONI DHE SYNIMET	5
OBJEKTIVI.....	5
SFIDAT.....	6
KORNIZA LIGJORE	6
PROFILI I KOMUNËS SË PODUJEVËS - POZITA GJEOGRAFIKE	8
KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE.....	9
PROJEKTET PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË BANIMIT NË KOMUNËN E PODUJEVËS.....	11
KËRKESAT FAKTIKE PËR PËRKRAHJE	16
KATEGORITË E SYNUARA	20
KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SË PËRPARËSISË	21
PLANIFIKIMI KONKRET PËR BANIM SOCIAL.....	21
PLANIFIKIMI BUXHETOR DHE REALIZIMI I PROGRAMIT	22
ANALIZA E FAKTEVE – PËRMBLEDHJE.....	23
INSTRUMENTET MBIKQYRËSE	26
TRANSPARENCA DHE PËRFSHIRJA E PUBLIKUT	27
ÇËSHTJET E TJERA	27
SWOT ANALIZA	28
PËRFUNDIMI	30
BURIMI I TË DHËNAVE	30

HYRJE

Banimi është një nga të drejtat themelore të njeriut që garanatohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me konventat e miratuara nga Kombet e Bashkuara në vitin 1948 të cilat janë të adaptuara nga pothuajse të gjitha shtetet e botës e gjithashtu edhe nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Si çështje sociale dhe çështje e planifikimit strategjik të një vendi, adresimi i çështjes së banimit në mënyrë të duhur siguron zhvillim social dhe ekonomik të qëndrueshëm.

Republika e Kosovës e ka të rregulluar legjislacionin sa i përket banimit social, me Ligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit Nr. 003/L-164 që paraqet një kornizë të avancuar për nivelin lokal për të ofruar banim të qëndrueshëm për qytetarët. Duke pasë parasysh rëndësinë që ka banimi dinjitoz për qytetarët, padyshim se Komuna e Podujevës i kushton kujdes të veçantë qështjes së banimit social e posaqërisht rasteve të familjet në nevojë. Me theks të veçantë kemi banimin social që nënkupton ndihmë për familjet në nevojë, atyre të cilët nuk janë në gjendje të bëjnë zgjedhjen e këtij banimit, prandaj është përpiluar Programi Trevjeçar i Banimit i cili i referohet zgjedhjes së çështjes së banimit social në Komunën e Podujevës.

Ky program do të mundësojë kushtet për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për familjet të cilat ende nuk e kanë të zgjedhur çështjen e banimit ose jetojnë në kushte minimale të banimit. Komuna e Podujevës në programet e saj zhvillimore ka për qëllim përmirësimin e banimit social për banorët e saj. Programi Trevjeçar i Banimit është punuar sipas metodologjisë përshkruese dhe interpretuese duke u bazuar në të dhëna konkrete të gjendjes ekzistuese, si dhe nga rezultatet e programit paraprak.

Fazat e hartimit të programit:

- Vendimi i Kryetarit për hartimin e Programit Trevjeçar të Banimit 2026-2028,
- Analiza e gjendjes, identifikimi i grupeve të synuara, Swot Analiza,
- Planifikimi i zonave për ndërtim të objekteve për banim social dhe
- Kriteret kryesore për familjet që bëjnë kërkesë për të përfituar nga programet e veçanta të banimit.

Drejtoritë përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e programit:

- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

- Drejtoria për Pronë , Kadastër dhe Gjeodezi.

QËLLIMI

Qëllimi i hartimit të Programit Trevjeçar të Banimit në Komunën e Podujevës është identifikimi i çështjeve të banimit brenda territorit të saj, duke u bazuar në politikat qendrore dhe të zhvillojë politika adekuate për zgjidhjen e nevojave për banim për grupe të caktuara të cilët nuk kanë mundësi ekonomike dhe sociale për të siguruar banim me çmime të tregut.

Realizimi i këtij programi planifikohet të bëhet përmes fondeve vetanake, investimeve nga niveli qendror, donatorëve të ndryshëm dhe përmes këtij programi tentohet të arrihet përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të jetesës për qytetarët e Komunës së Podujevës të cilët kanë nevojë për mbështetje në fushën e banimit.

Financimi i programeve të veçanta të banimit është në përputhje me Ligjin Nr.03/L 164, për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe njëkohësisht, i nënshtrohet zbatimit të metodës së planifikimit strategjik.

VIZIONI DHE SYNIMET

Vizioni dhe qëllimi në këtë program është përmirësimi i cilësisë së jetesës për qytetarët si e drejtë e garantuar në çdo kornizë ligjore.

Komuna e Podujevës është vend që ofron mundësi për qytetarët që të gëzojnë të drejtat e tyre për një standard më të mirë të jetesës, për të gjitha komunitetet, banim të përshtatshëm, pjesëmarrje në qeverisje si dhe ofrimit të mundësive të barabarta për të gjithë.

Komuna e Podujevës synon tërheqjen e investimeve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit të jetesës në përgjithësi që rezultojnë në reduktimin e numrit të familjeve që kanë nevojë për mbështetje në fushën e banimit social.

OBJEKTIVI

Komuna e Podujevës ka si objektiv që të krijojë kushte për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit, ashtu që të mundësojë zgjidhje të nevojave për banim për individët apo familjet të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë dhe kanë nevojë për ndihmën e Komunës.

Objektivat strategjike të programit janë në përputhje me kushtet (parimet) e planifikimit hapësinor të qëndrueshëm.

SFIDAT

- Kapacitete jo të mjaftueshme buxhetore për zhvillimin e banimit social për ndërtim , renovim të shtëpive apo pagesa të qirasë.
- Mungesa e pronës.
- Kosto e lartë e banimit.
- Shkalla e lartë e papunësisë.
- Kosto e lartë e pajisjes me infrastrukturë adekuate.
- Identifikimi i vazhdueshëm i rasteve të cilat kanë nevojë për banim.
- Mungesa e përfishirjes së donatorëve.
- Mungesa e sektorit për banim.

KORNIZA LIGJORE

Programi i prezantuar Trevjeçar për Banim i Komunës së Podujevës bazohet në legjislaturën si në vijim;

Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit Nr.03/L-164

Ligji për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, Nr. 04/L-134

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-40

Ligji për ndërtim Nr. 04/L –110

Ligji për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, Nr.04/L-061

Ligji për Procedurat Administrative, 05/L-031 date 21.06.2017

Statuti i Komunës

Udhëzimi Administrativ për Përmbajtjen e Kontratës për banesa me qira joprofitabile, Nr10/2010, date 02.09.2010

Udhëzimi Administrativ për Përmbajtjen e bonusit të banimit Nr 19/2010;

Udhëzimi Administrativ për Procedurat për përfitimin nga programet e veçanta të banimit Nr. 22/2010;

Udhëzimi Administrativ për Procedurat për shpalljen e programeve të veçanta të banimit Nr

23/2010;

Udhëzimi Administrativ për Normat minimale të banimit Nr. 24/2010;

Udhëzimi Administrativ për Kriteret e përcaktimit të radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet Nr.21/2010;

Dokumentet e Planifikimit Urban

Plani Zhvillimor i Komunës së Podujevës 2016-2025

Harta zonale Komunale 2021-2030

Plani Trevjeçar i Banimit 2023-2025

STRATEGJITË E NIVELIT QEVERITAR

- Strategjia për avancimin te drejtave te komunitetit Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026
- Strategjia Kombëtare për Ri-integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar
- Strategjia për komunitet dhe kthim.

METODOLOGJIA PËR PËRPILIM TË PROGRAMIT

- Sigurimi i të dhënave (Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Zyra për Komunitete, dhe drejtoritë tjera përkatëse)
- Struktura e Buxhetit Komunal
- Përpilimi i draftit final
- Bërja publike e Programit Trevjeçar të Banimit – informim
- Procedura e miratimit të dokumentit
- Aprovimi nga Kuvendi i Komunës
- Mekanizmi përgjegjës për realizimin e këtij programi do të jenë Komuna me drejtoritë përkatëse, dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

PROFILI I KOMUNËS SË PODUJEVËS - POZITA GJEOGRAFIKE

Komuna e Podujevës ka pozitë të mirë gjeografike, shtrihet në pjesën veri - lindore të Republikës së Kosovës. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2024 në Komunën e Podujevës jetojnë 70,975 banorë me një sipërfaqe prej 628.7km², me 20,330 banorë në qytet dhe 50,645 banorë në fshatra.

Në kufirin kadastral Komuna e Podujevës kufizohet me:

Në jug me Komunën e Prishtinës (në gjatësi prej 37.39 km), në perëndim me Komunën e Obiliqit, Vushtrisë, Mitrovicës dhe Lepostaviqit (në gjatësi prej 46.92 km), dhe në veri-lindje me Republikën e Serbisë (në gjatësi prej 90.90 km). Komuna e Podujevës përbëhet nga 78 vendbanime (zona kadastrale) të cilat ndërlidhen nëpërmjet trafikut shtetëror, kjo ndërlidhje bëhet përmes rrugëve:

M25	Magjistralla Podujevë -Prishtinë
R-125	Lluzhan -Batllavë - Bërvenik/Kufiri me Serbinë
R-126	Batllavë -Podujevë - Reçicë
R-127	Llapashticë e Poshtme -Podujevë - Përpellac/Kufiri me Serbinë
R-128	Podujevë - Maxhunaj (Lidhje e papërfunduar)
R-129	Mitrovicë - Bajqinë

Tabela 1. Rrugët ndërlidhëse të Komunës së Podujevës

Karakteristikë e veçantë e Podujevës është edhe pasuria e vlerave të mëdha trashëgimore-kulturore. Sipas të dhënave dhe zbulimeve historike e arkeologjike, Komuna e Podujevës, pjesë e Dardanisë antike, është tejet e pasur me vlera materiale autoktone. Zbulime arkeologjike janë gjetur në shumë vendbanime. Për shkak të vlerave të larta natyrore të tërsisë së Liqenit të Batllavës por edhe rëndësia e shfrytëzimit të ujit të pijshëm (në katër komuna të Republikës së Kosovës).



Foto 1. Liqeni i Batllavës

KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE

Popullsia

Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2024 janë evidentuar 70,975 banorë. Struktura gjinore e popullsisë është e ndarë si vijon:

Komuna e Podujevës	STRUKTURA GJINORE		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej
	35,155	35,820	70,975

Tabela 2. Struktura gjinore e popullsisë në Komunës së Podujevës (të dhëna nga Agjensia e Statistikave të Kosovës.

Mosha	0-4	5-19	20-39	40-64	65-84	85+	Gjithsej
Banorë	4882	17523	20729	20765	6752	324	70,975

Tabela 3. Popullsia sipas grupmoshave në Komunën e Podujevës (Të dhëna nga Agjensia e Statistikave të Kosovës - 2024)

Vendbanimet

Pjesa më e madhe e objekteve të banimit i takon karakterit individual, ndërsa në qendër urbane janë një numër i objekteve banesore që i takon karakterit kolektiv.

Pjesa dërmuese e popullsisë në komunën e Podujevës (73.5 % e popullsisë) jeton në fshat. Pjesa më e madhe e objekteve të banimit i takon karakterit individual, ndërsa në qendrën urbane janë një numër i vogël i objekteve banesore që i takon karakterit kolektiv. Numri i përgjithshëm i objekteve të banimit në kuadër të Komunës së Podujevës është 12315, nga e cila shumë, 7891 objekte ose 64.1 % janë të ndërtuara në zonat rurale, ndërsa 4424 objekte të banimit, ose 35.9 % e tyre janë të ndërtuara në zonën urbane. Në zonën e ulët të fushës vendbanimet zakonisht janë të tipit të grumbulluar, prandaj edhe dendësia e banimit është më e madhe. Për nga cilësia e materialit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtuar dhe pajisjes së hapësirës banuese, kjo hapësirë gjithashtu disponon me një fond më cilësor banesor. Dendësia mesatare e banimit në nivel të komunës arrin në 141 banorë në një km², në territorin e komunës kadastrale të qytetit arrin në rreth 2635 banorë në km², kurse në vendbanimet rurale është 105 banorë në km². Hapësirat me dendësi më të madhe janë rreth qendrës komunale dhe në zonën e rrafshët, ku dendësia e banimit arrin mbi 500 banorë në km² dhe kështu tejkalon mesataren e dendësisë së hapësirës së komunës. Objektet e vjetra të banimi janë të pakta sepse materiali i dobët i tyre nuk ka mundur t'i rezistoi kohës. Objektet e banimit dhe oborret kanë dallime, varësisht nga vendi i ndërtimit, si: qyteti, vendbanimet pranë qytetit,

Gjendja e banimit në vendbanimet e Komunës së Podujevës u dëmtua në masë të konsiderueshme në luftën e fundit, gjatë së cilës u shkatërruan një numër i konsiderueshëm i objekteve të banimit dhe ekonomike, ndërsa pasojat po evitohen ngadalë. Hapësira e banimit në raport me sipërfaqet e ndërtuara është dominante, me rreth 50% në raport me zonën e ndërtuar në vendbanimet rurale, kurse në vet qytetin hapësira e banimit dominon me rreth 80%.

PROJEKTET PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË BANIMIT NË KOMUNËN E PODUJEVËS

- Komuna e Podujevës ka realizuar projektin për renovimin e banesave, objekteve banesore në qytet të ndërtuara në periudhën para luftës, duke bërë izolimin e mureve, kulmeve, dyert e hymjeve kryesore duke përmirësuar kështu komoditetin e banorëve në funksion kursimin e energjisë në mënyrë që të jemi sa më afër normave dhe rregullave për eficiencën e energjisë.



Foto 2. Renovimi i objekteve shumë banesore në qytet

- Në vitin 2022 Komuna e Podujevës ka nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi me Shoqatën Jetimat e Ballkanit për ndërtimin e 10 shtëpive për rastet sociale, ku 10 familje l'u është siguruar banimi si dhe 6 shtëpi tjera janë ndërtuar në bashkepunim me donatorë. Gjate vitit 2022, Komuna e Podujevës ka strehuar nje familje nga Komuniteti në Lagjen e Dëshmorëve, ku gjendja e tyre e banimit ka qenë në kushte mjaft të rënda në objektin e stacionit te trenit.

- Në vitin 2023 , Komuna në bashkëpunim me fondacionin Shqiptarët për Shqiptarët ka bërë ndërtimin e 22 shtëpive për familjet në nevojë në Lagjen e Re në Podujevë, familje me femijë jetim, raste sociale , familje nga Komuniteti. Në këto shtëpi kemi strehuar edhe familjet të cilët kanë qenë duke banuar në kushte të rënda të banimit në objekte te improvizuara per banim- objektet montazhe ne rrugën Hyzri Talla (baraka të cilat tashmë janë rrënuar),dhe ne rrugën Nuhi Gashi. Një shtëpi është ndërtuar në bashkëpunim me donatorë.
- Në vitin 2024, Komuna ka nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për Projektin e Banimit të Përballueshem, projekt I cili ka filluar të realizohet, ku perfshihen ndërtimi I njësive të reja të banimit në zonën e ish tregut. Ky kompleks do të ketë gjithsej 133 njësi banimi, prej të cilave 106 do të jenë njësi të banimit të përballueshëm, ndërsa për banim social do të jenë 27.

Vlera e projektit është gati 13.6 milionë euro dhe punimet planifikohen të finalizohet mbrenda tre viteve. Sipërfaqja e tërësishme e ndërtimit do të jetë 20,180.01 m². Banesat do të jenë të katër tipeve: 53 m², 66 m², 77 m² dhe 87 m². dhe punimet planifikohen të finalizohet brenda 3 vjetëve. Ky projekt realizohet në bashkëpunim ndërmjet ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunës, me ç’rast komuna kontribuon me lokacionin dhe infrastrukturën përcjellëse, ndërkaq investimin kapital dhe mbikëqyrjen e punimeve bëhet nga Ministria. Ky kompleks do të ketë gjithsej 133 njësi banimi, prej të cilave 106 do të jenë njësi të banimit të përballueshëm, ndërsa për banim social do të jenë 27.

- Gjatë vitin 2024 në bashkëpunim me donatorë, janë ndërtuar 3 shtëpi për familjet sociale.
- Në vitin 2024, në Komunën e Podujevës ka filluar ndërtimi i Qendrës Rezidenciale për të Moshuar në bashkëfinancim Komuna e Podujevës dhe shoqata "Jetimat e Ballkanit". Ky projekt është në fazën e inventarizimit. Objekti përveç qëndrimit ditor për të moshuar do ta ketë edhe kuzhinën popullore për ofrimin e shujtave ditore për 200 persona, bujtinën për nxënës, hapësira rekreative, parkun, shërbimin parësor shëndetësor, dhoma fizioterapeutike etj.
- Në vitin 2025, Komuna ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me “Shoqatën Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin e 5 shtëpive me participim të Komunës ku deri më tani janë ndërtuar 3 shtëpi. Gjithashtu në bashkëpunim me donatorë privat, janë ndërtuar 7 shtëpi për familjet raste sociale.
- Komuna e Podujevës ka aplikuar në Thirrjen për Shpreje te Interesit nga MMPHI dhe është përfituese e Projektit për Banim Social Adekuat. Në Dhjetor të vitit 2024, Komuna ka

nënshkruar marrëveshje me MMPHI për Projektin e Banimit Social Adekuat për ndertimin e Njesive të reja të banimit si dhe për rindërtimin dhe renovimin e shtëpive. Sipas projektit, do të bëhet ndertimi i njësive të reja të banimit, rindërtimi i 10 shtëpive dhe renovimi i 40 shtëpive për rastet sociale dhe familjet me të hyra të ulëta.

- Në vitin 2025, Komuna e Podujevës ka bërë hapjen e Thirrjes Publike për Shprehje të Interesit për nën-projektin “Renovimi/Rindërtimi i shtëpive private për familjet e cënueshme” në kuadër të Projektit “Banimi Social Adekuat”.

Nën-projekti synon të renovojë/rindërtojë shtëpitë ekzistuese në pronësi të familjeve të cënueshme, të varfra deri në ato me të ardhura më të ulëta, për t’i bërë ato të përshtatshme për jetesë dhe më efikiente në energji. Projekti për Banim Social Adekuat në Republikën e Kosovës do të zbatohet nga Ligji Nr.08/L302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MPFT) dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për projektin “Banimi Social Adekuat”. Kredia nga BZHKE me vlerë totale prej 25 milion euro, do t’i jepet si financim Komunave të Republikës së Kosovës, së bashku me kontribut nga MMPHI prej 12 milion euro, të rrisë numrin e njësive të banimit social dhe të përmirësojë kushtet e jetesës për familjet me të ardhura të ulëta deri në mesme. Ky Projekt ka ofruar mundësinë për Komunën e Podujevës në përfitimin e financimit nga MMPHI për realizimin e projekteve për Banim Social Adekuat, Ky projekt përfshinë;

- Ndërtimin e Njësive të reja për banim për familjet raste sociale dhe me të hyra të ulëta.

- Renovimin dhe rindërtimin të shtëpive private për familjet raste sociale dhe me të hyra të ulëta.

Në kuadër të Komunës është themeluar Komisioni Vlerësues për verifikim dhe vlerësim të Shprehjes së interes – Aplikacioneve për nën- projektin Renovimi dhe Rindërtimi i shtëpive private për Familjet apo Individët e Cënueshëm. Komisioni ka bërë vlerësimin dhe verifikimin e 113 familjeve aplikuese. Tashmë jemi në fazën e kompletimit të dokumentacionit sipas rekomandimeve nga Ministria për familjet e propozuara.

Financimi i projektit do të mbulojë kostot për renovimin apo rindërtimin e shtëpive private duke përmirësuar kështu kushtet e jetesës për familjet e cënueshme që përballen me vështirësi ekonomike dhe që nuk mund të përmbushin nevojat bazë për banim. Vlerësimi i gjendjes së familjeve aplikuese është vlerësuar nga komisioni duke bërë verifikimin e gjendjes ekonomike, sociale, shëndetësore si dhe gjendjes së tyre të banimit, duke zbatuar kriteret e përcaktuara të poentimit, radhët e përparësisë duke u referuar në Udhëzimit Administrativ për Procedurat për përfitimin nga programet e veçanta të banimit Nr. 22/2010;

Udhëzimi Administrativ për Procedurat për shpalljen e programeve të veçanta të banimit Nr 23/2010;

Udhëzimi Administrativ për Normat minimale të banimit Nr. 24/2010;

Udhëzimi Administrativ për Kriteret e përcaktimit të radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet Nr.21/2010;



Shtojca Nr. 1. Kriteret sipas radhës së përparësisë

Nr.	TABELA E VLERËSIMIT SIPAS KRITERËVE TË PËRPARËSISË			Pikët
I	STATUSI I BANIMIT	1.1	Familjet që jetojnë në objekte të rrezikshme ose të papërshtatshme për banim.	10
		1.2	Familjet që jetojnë në objekte që janë nën normat minimale të banimit.	8
		1.3	Familjet që jetojnë në objekte të huaja.	6
		1.4	Familje që jetojnë me qira të tregut për më shumë se 5 vjet.	4
II	LARTËSIA E TË ARDHURAVE	2.1	Familjet me të ardhura mbi kufirin minimal deri në 150 Euro.	10
		2.2	Familjet me të ardhura nga 150 - 250 Euro.	8
		2.3	Familjet me të ardhura nga 250 - 300 Euro.	6
		2.4	Familjet nën kufirin minimal të të ardhurave të përcaktuara sipas nenit 6, të Ligjit, që subvencionohen nga komuna.	10
III	GJENDJA SHËNDETËSORE	3.1	Familjet me përkujdesje të personave, fëmijëve me çrregullime të përhershme shëndetësore.	8
		3.2	Sëmundje të rënda kronike konsiderohen: sëmundjet malinje, sëmundjet e rënda të gjakut, diabeti tek rastet e rënda me insulinë, sëmundjet e ndryshme kronike të veshkave në dializë dhe pas transplantëve të veshkës, forma të rënda të astmës, sëmundjet kronike të papërcaktuara të mushkërive, tuberkulozi, skleroza, sëmundjet e sistemit imunitar, format e rënda të çrregullimeve të metabolizmit, epilepsia, sëmundjet tjera të rënda të zemrës dhe neurozat.	6
IV	INVALIDITETI	4.1	Invalid me mbi 80% të dëmtimit trupor, të cilëve për jetë normale u nevojitet përkujdesja dhe ndihma e një personi tjetër.	10
		4.2	Invalid me 71% deri 80% të dëmtimit trupor.	9
		4.3	Invalid me 61% deri 70% të dëmtimit trupor.	8
		4.4	Invalid me 51% deri 60% të dëmtimit trupor.	7
		4.5	Invalid me 41% deri 50% të dëmtimit trupor.	6
		4.6	Invalid me 31% deri 40% të dëmtimit trupor.	5
		4.7	Invalid me 21% deri 30% të dëmtimit trupor.	4
		4.8	Invalid me 10% deri 20% të dëmtimit trupor.	3
V	STRUKTURA E FAMILJES	5.1	Të moshës 0-5 vjet që kanë nevojë për përkujdesje të plotë.	8
		5.2	Ndërmjet moshës 6 - 18 vjeçare, që janë në shkollim.	6
		5.3	Ndërmjet moshës 18 - 25 vjeçare, që janë në shkollim.	4
		5.4	Të moshës mbi 65 vjeçare.	3
VI	KRITERET SHITESË	6.1	Familje dëshmori.	10
		6.2	Familje e kryesuar nga një prind.	9
		6.3	Familje në përkujdesje të fëmijëve jetim.	8
Gjithsej:				

¹ Familjet me të ardhura nën kufirin minimal të përcaktuara sipas nenit 6 të Ligjit vetëm në rastet kur komuna subvencionon qiranë joprofitabile sipas paragrafit 3 të nenit 7 të këtij Udhëzimi administrativ.

Komuna e Podujevës për momentin nuk ka banesa të ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët të cilat jepen me qira joprofitabile por planifikohet që do të inicohen programe në këtë drejtim.

Përparësitë në përzgjedhjen e përfituesve për subvencionim të qirasë do të kenë:

- 1.1. Familjet me shumë fëmijë;
- 1.2. Familjet që në përbërjen e tyre kanë persona me aftësi të kufizuara;
- 1.3. Familjet ku kryefamiljari është grua-mbajtëse e familjes;
- 1.4. Bashkëshorti ose bashkëshortja e shkurorëzuar që ka në përkujdesje fëmijë;
- 1.5. Fëmijët me statusin e jetimit.

Kjo do të bëhet në përputhje të plotë me Ligjin për Financimin e Programeve për Banim. Sipas këtij ligji, sigurimi i banimit bëhet përmes financimit të programeve të veçanta të banimit me qira, ku përfshihen:

- a) banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira;
- b) banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;
- c) banesat tjera në pronësi të Komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim.

Komuna e Podujevës për momentin nuk ka banesa të ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët të cilat jepen me qira por planifikohet që do të inicohen programe në këtë drejtim.

KËRKESAT FAKTIKE PËR PËRKRAHJE

Viti	Numri I kërkesave dhe vizitave	Shtëpите e ndërtuara në bashkëfinancim me Shoqatën Jetimat e Ballkanit dhe nga vetë Shoqata	Të ndërtuara nga donatorët	Banimi në dy Lagjet
2022	73 familje kane aplikuar per ndertim te shtepive	Komuna ka nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi me Shoqatën Jetimat e Ballkanit për ndërtimin e 10 shtëpive për rastet sociale	6 shtëpi janë ndërtuar nga donatorët gjatë vitit 2022	Në Lagjen e Dëshmoreve janë duke banuar 112 familje
2023	59 familje kane aplikuar per ndertimin e shtepive	22 shtëpi jane ndertuar ne bashkepunim me Shoqaten Shqiptaret per Shqiptarët ne Lagjen e Re Ka vazhduar ndërtimi I shtëpive sipas marrëveshjes me Shoqatën Jetimat e Ballkanit	1 shtëpi është ndërtuar nga donatori ne bashkëpunim me Komunën	- Ne Lagjen e Dëshmorëve janë duke banuar 112 familje. -Gjatë vitit 2023 në Lagjen e re janë vendosur 22 familje
2024	16 familje kane aplikuar per ndertimin e shtepive	Komuna ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me MMPHI per Projektin e Banimit te Përbalueshem project I cili ka filluar të realizohet, ku përfshihen ndërtimi I	3 shtëpi janë ndërtuar nga donatorët në bashkëpunim me Komunën	- Në Lagjen e Dëshmorëve janë duke banuar 112 familje -Në Lagjen e Re janë duke banuar 22 familje

		njësive te reja të banimit Janë vazhduar kontratat për 22 familje për banim Komuna ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me MMPHI për Projektin e Banimit Social Adekuat per ndërtimin e Njësive të reja të banimit si dhe për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive.		
2025	157 familje kanë aplikuar per ndërtimin e shtëpive	-Komuna ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me Shoqatën Jetimat e Ballkanit per ndertimin e 5 shtepive me participim te Komunes ku 3 shtepi jane ndertuar. Komuna ka hapë thirrje publike për shprehje të interesit për aplikime për renovim dhe rindërtim të shtëpive për familjet e ceneshme ku kanë aplikuar 113 familje. Numri I familjeve të cilët kanë aplikuar për banim social është 40 dhe prej tyre 22 familje janë të sistemuara ne Lagjen Shqiptaret per Shqiptaret dhe 18 jane ne listen e pritjes per banim social. Nuk kemi familje që gjatë vitit 2025 ka liruar banimin social.	7 shtëpi janë ndërtuar nga Donatorët gjatë vitit 2025 në bashkëpunim me Komunën	- Në Lagjen e Dëshmoreve janë duke banuar 112 familje Ne Lagjen e Re janë duke banuar 22 familje

--	--	--	--	--

Tabela 4. Gjendja aktuale, kërkesat dhe analizat



Foto 3. Shtëpitë për banim social në Lagjen e Dëshmorëve



Foto 4. Shtëpitë për banim të ndërtuara nga Fondacioni Shqiptarët për Shqiptarët në bashkëpunim me Komunën e Podujevës



Foto 5. Shtëpitë për banim të ndërtuara nga Komuna në bashkëfinancim me Shoqatën Jetimat e Ballkanit

Objektet tjera pronë publike në të cilat banojnë familjet , qështja e pronësisë të së cilave është ende e pazgjidhur janë;

Në objektin banesor afër stacionit hekurudhor, çështja e pronës është ende e padeфинuar. Në këtë objekt janë të vendosura 23 familje që nga koha e pas luftës. Komuna ka investuar në rregullimin e jashtëm të këtij objekti në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për banim. Këto familje janë të identifikuara por çështja ligjore e banimit të tyre ende mbetet e pazgjedhur.



Foto 6. Objekti banesor te Hekurudha" (në të cilën jetojnë 23 familje)

KATEGORITË E SYNUARA

Programin e banimit për tre viteve të ardhshme e kemi filluar nga gjendja ekzistuese dhe duke vazhduar me programet e veçanta për banim që është e rregulluar me ligj.

Ky program planifikohet të jete i zbatueshëm duke përfshirë numrin e familjeve që do të ndihmohen në tri vitet e ardhshme, mënyrën se si do të ndihmohen në bazë të programeve të veçanta për banim si dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e duhur të këtij programi.

Kategoritë të cilat synohen të përfshihen në program për tre vitet e ardhshme janë kategoritë e familjeve të cilat nuk kanë mundësi buxhetore të sigurojnë banimin.

Në bazë të këtij programi do të bëhet regjistrimi dhe shqyrtimi i kërkesave të familjeve të cilët aplikojnë për banim apo përmirësim të kushteve të banimit në bazën e të dhënave, nga ku do të jetë më e lehtë qasja në kërkesat e tyre. Vizitat në shtëpi do të bëhen në mënyrë që të bëhet verifikimi i gjendjes së banimit dhe socio ekonomike.

Komuna e Podujevës planifikon buxhetin ku do të ndërtohen shtëpi për familjet në nevojë nga Komuna si dhe në bashkëfinancim me shoqata dhe donatorë të ndryshëm në menyrë që të bëhet zgjedhja e banimit për keto familje.

Do të vazhdojmë bashkëpunimin me donatorë duke propozuar familjet kërkuese në mënyrë që të paraqitet gjendja e tyre.

Sipas Ligjit për Programet e Veçanta të banimit, planifikohet subvencionimi i një pjese të qirasë për familjet që nuk kanë mundësi që të sigurojnë çështjen e banimit dhe kanë nevojë për ndihmë financiare nga Komuna.

Sigurimi i tillë i banimit bëhet përmes financimit të programeve të veçanta të banimit me qira joprofitabile, ku përfshihen:

- Banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat mund të jepen me qira joprofitabile.
- Banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira joprofitabile për familjet që posedojnë bonus të banimit.
- Banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim.

Formë tjetër nga programet e veçanta për banim është edhe ndihma familjeve në nevojë për renovim të shtëpive apo adaptim në objektet për banim.

Familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta për Banim përfshijnë familjet që:

- Nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale.
- Kanë mbetur pa banesë-shtëpi, si rezultat i dëmtimit të shtëpive të vjetra.
- Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.

KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SË PËRPARËSISË

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit kriteret e përparësisë për sigurimin e banimit për kategoritë e cekura në pikën 7.1 janë:

- Statusi i banimit
- Lartësia e të ardhurave
- Gjendja shëndetësore
- Invaliditeti
- Struktura e familjes

PLANIFIKIMI KONKRET PËR BANIM SOCIAL

Programi për banim i Komunës së Podujevës është hartuar për periudhën 2026-2028. Komisioni i formuar nga ana e Kryetarit të Komunës ka bërë analizë të gjendjes ekzistuese dhe ka përgatitur propozime konkrete për të ndihmuar qytetarët e Komunës së Podujevës që nuk kanë mundësi të sigurojnë banim. Gjithashtu është themeluar Njësi për Implementimin e Projektit për Banim Social Adekuat (NjIP). NjIP, do të funksionojë si organ kryesor i Implementimit të Projektit përmes nën-projekteve të Banimit Social Adekuat në kuadër të Komunës dhe si ndihmës i organit kompetent komunal për menaxhimin e kontratave dhe Projektit të Banimit Social Adekuat përmes nën-

projekteve

Programi i prezantuar tre vjeçar për Banim ka keto objektiva:

- Implementimi i Projektit për Banim të Përbalueshëm i cili është duke u realizuar.
- Implementimi i Projektit për Banim Social Adekuat për Komunën e Podujevës i cili përfshinë tri nën-projektet, dhe tashmë gjendet në fazën e kompletimit të dokumentacionit të aplikuesve. Këto tri nën- projekte përfshijnë;
 - Ndërtimin e Njësive të reja për Banim Social, në lokacionit e propozuar afër Lagje së Dëshmorëve ku do të përfitojnë përafërsisht 20 familje raste sociale dhe me të hyra të ulëta.
 - Vazhdimi i procesit të punës së Njesitit për Implementimin e Projektit .
 - Rindërtimi i 10 shtëpive dhe renovimi i 40 shtëpive për familjet në nevojë.
- Hapja e Qendrës Rezidenciale për të Moshuar, projekt në bashkëfinancim Komuna e Podujevës me Shoqatën Jetimat e Ballkanit.
- Vazhdimi i ndërtimit të shtëpive për familjet sociale në bashkëfinancim me Shoqatën Jetimat e Ballkanit dhe donatorë.
- Verifikimi i banimit dhe vazhdimi i kontratave për 22 familjet në Lagjen e ndërtuar në bashkëpunim me Fondacionin Firdeus dhe Shqiptarët për Shqiptarët.
- Vlerësimin e gjendjes së banimit të familjeve në Lagjen e Dëshmorëve.
- Vizitat dhe vlerësimin e gjendjes tek të gjitha familjet të cilat kërkojnë strehim, ndërtim të shtëpive, riparim apo pagesa për qera.
- Bashkëpunimin me donatorë për të bashkëfinancuar projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për qytetare.
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me MMPHI për ndërtim dhe renovim të shtëpive për rastet sociale dhe familjet nga komunitetet.
- Bashkëpunimin me biznese për parteritet publiko privat.

PLANIFIKIMI BUXHETOR DHE REALIZIMI I PROGRAMIT

Për realizimin e Programit trevjeçar për Banim për vitet 2026-2028, Komuna e Podujevës ka bërë planifikim buxhetor në bazë vjetore.

Gjithashtu, në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Komunës së Podujevës me MMPHI është duke realizuar Projekti për Banim të Përbalueshëm.

Komuna ka nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit me MMPHI për Projektin Banim Social Adekuat ku planifikojmë të realizojmë ndërtimin e Njësive të re të banimit në parcelën tek Lagja e Dëshmorëve ku planifikohen të jenë afërsisht 20 njesi banesore.

Si nën-projekt I Banimit Social Adekuat jemi në fazën e kompletimit të dokumentacionit të prones për familjet individuale për të cilët do të realizohet rindertimi I 10 shtëpive dhe renovimi I 40 shtëpive në bazë të këtij projekti

Qendra Rezidenciale për të Moshuar planifikohet të fillojë shërbimet gjatë fillimit të vitit 2026.

Komuna e Podujevës do të vazhdojë kontaktet dhe bashkëpunimin me donatorë të ndryshëm të cilët janë të interesuar të ndihmojnë familjet të cilat kanë nevojë për banim që të ju ndërtohen apo renovohen shtëpitë individuale. Kjo është forma më e qëndrueshme për të siguruar banimin për këto familje. Komuna e Podujevës do të vazhdojë të ofrojë informatat relevante dhe do të inicojë programe në këtë drejtim.

Mënyra e ndihmës	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Totali
Shërbimet Rezidenciale	230,000	200,000	200,000	630.000,00

Tabela 5. Buxheti i planifikuar për Shërbime Rezidenciale për vitet 2026 - 2028

Duhet cekur se përveç buxhetit të lartpërmendur të zotuar nga vetë Komuna e Podujevës, do të kërkohej buxhet nga niveli qendror si dhe donatorët.

ANALIZA E FAKTEVE – PËRMBLEDHJE

1.	Qëllimi i hartimit të programit tre vjeçar	Qëllimi kryesor i përpilimit të Programit Trevjeçar në Komunën e Podujevës është që të ndihmohen familjet të cilat kanë nevojë për banim social e nuk kanë mundësi vetanake për të siguruar banim apo përmirësim të kushteve të tyre të banimit.
2.	Baza ligjore	Ky program bazohet në legjislaturën ekzistuese të Republikës së Kosovës të përshkruar në kapitujt e sipërm të këtij dokumenti. Sidoqoftë dy dokumentet kryesore janë; Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim (03/L – 164) dhe Udhëzuesin për Hartimin e Programeve tre vjeçare për Banim. Është i paraparë afati 3 vjeçar të jetë më i përshtatshëm për të hartuar dhe për të dhënë në jetë programet e banimit, duke marrë parasysh veçoritë e Komunës së Podujevës si psh : politikat komunale të banimit (si

		veçori përkatëse), pozita gjeografike, demografike dhe institucionale.
3.	Llojet e programeve të konsideruara si të nevojshme	• Implementimi i Projektit për Banim të Përballueshëm i cili është duke u realizuar. • Implementimi i Projektit për Banim Social Adekuat për Komunën e Podujevës i cili përfshinë tri nën projektet, dhe tashmë gjendet në fazën e kompletimit të dokumentacionit të aplikuesve. Këto tri nën Projekte përfshijnë; -Ndërtimi i Njësive të reja për Banim Social, -Rindërtimi dhe renovimi i shtëpive për familjet në nevojë. • Hapja e Qendrës Rezidenciale për të Moshuar. • Vazhdimi i ndërtimit të shtëpive për familjet sociale në bashkëfinancim me donatorë. • Pagesa e qerasë për familjet në nevojë.
4.	Prezantimi i gjendjes faktike	Aktualisht kemi kërkesa të vazhdueshme për sigurim banimi, ndërtim dhe renovim të shtëpive dhe pagesa për qera nga familjet raste sociale.
5.	Kërkesat faktike për përkrahje me sigurim të banimit	• Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi. • Familjet që nuk posedojnë sipërfaqe banimi. • Familjet që janë me kategori sociale, nënat vetushqyese, familje me të hyra të ulta të cilët nuk mund e përballojnë sigurimin e banimit. • Kategoritë e dala nga lufta ,të riatdhesuarit dhe komunitetet. • Vazhdimi i kontratave për banim të përkohshëm në Lagjen e Re.
6.	Klasifikimi i nevojave sipas urgjencës së trajtimeve të tyre	Do të merren parasysh kriteret e përcaktuara sipas Ligjit nr. 03/L – 164. Do të përdoret Aplikacioni për Mbledhjen e të Dhënave Hapësinore për Banim Social dhe të Përballueshëm
7.	Veprimet kryesore që do të ndërmerren	• Implementimi i Projektit për Banim të Përballueshëm i cili është duke u realizuar. • Implementimi i Projektit për Banim Social Adekuat për

		Komunën e Podujevës që përfshinë tri nën projektet, i cili tashmë ka filluar dhe jemi në fazën e kompletimit të dokumentacionit të aplikuesve, siq janë; Ndërtimi i Njësive të reja për Banim Social, rindërtimi dhe renovimi i shtëpive për familjet në nevojë. • Hapja e Qendrës Rezidenciale për të Moshuar. • Regjistrimi i aplikuesve, kompletimi i dokumentacionit të nevojshëm. • Përdorimi i Aplikacionit për Mbledhjen e të Dhënave Hapësinore për Banim Social dhe të Përballueshëm. • Vizita në terren. • Krijimi i listës prioritare për ndihmë sipas mundësive buxhetore. • Nënshkrimi i kontratave me përfituesit e banimit social. • Pagesa e qerasë për familjet që nuk kanë mundësi ekonomike.
8.	Kohëzgjatja e realizimit të programeve	2026-2028
9.	Korniza shpenzimeve afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë	• Realizimi i Projektit për Banim të Përballueshëm. • Realizimi i Projektit për Banim Social Adekuat për ndërtimin e Njësive të reja të banimit, rindërtimi dhe renovimi i shtëpive private për familjet raste sociale dhe me të hyra të ulëta. • Hapja e Qendrës Rezidenciale për të Moshuar. • Ndarja e mjeteve buxhetore dhe bashkëfinancimin me donatorë për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive, pagesa e qerasë në bazë të kërkesave të qytetarëve, ku komisioni do të bëjë vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve përfituese.
10.	Mundësitë e kapaciteteve njerëzore dhe materiale	Komuna Njësi për Implementimin e Projektit për Banim Social Adekuat (NJIP) Donatorët

11.	Mënyra e financimit të programeve tre vjeçare (të plotësohet më detajisht në dokumentin me programet trevjeçare të banimit)	Buxheti komunal Niveli qendror- MMPHI dhe Ministritë tjera përkatëse Donatorët
12.	Përputhja e programeve me planet zhvillimore të komunës	PZHK dhe PZHU i miratuar ku janë definuar zonat e banimit
13.	Instrumentet mbikëqyrëse	Zyra e Kryetarit Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis Zyrtari për banim
14.	Instrumentet e garantimit të realizimit të programeve	Monitorimin, raportet, vendimet e Kuvendit Komunal dhe programet e ndryshme të caktuara, raportet nga Njësi për Implementim të Projektit për Banim Social Adekuat, NJIP.
15.	Transparenca me hartimin dhe zbatimin e programeve	Analizë, debate publike me ekspert të ndryshëm, raportet etj.

INSTRUMENTET MBIKQYRËSE

Formimi i Sektorit të Banimit brenda Komunës së Podujevës i cili do të jetë përgjegjës për të gjitha aktivitetet e planifikuara mundëson që Komuna të ketë mbikqyrje direkte në zbatimin e Projekteve

të Banimit. Ky sektor do të raportoj pranë Asamblesë Komunale çdo gjashtë muaj. Po ashtu edhe Ligji e parasheh që MMPHI të mbikëqyrë zbatimin përmes inspektorëve të urbanizmit.

Programi për Banim i Komunës së Podujevës mbulon periudhën 2026-2028. Komisioni ka përgatitur propozimet për projektet prioritare zbatimi i të cilave rezulton në arritjen e synimeve zhvillimore të përcaktuara në fushat kyçe, detyrimet, aktivitetet, bartësit kryesor, afatin kohor të implementimit, përgatitjes dhe koordinimit të aktivitetet të përgjithshme për implementimin e projekteve. Në mënyrë që të sigurojë zbatimin e projekteve të planifikuara do të shqyrtohet mundësia për formimin e Sektorit të banimit i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktivitetet të planifikuara.

Sektori i banimit është një organ i përhershëm që do të formohet me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të projekteve dhe detyrave nga Programi i banimit, si rishikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit dhe mbështetjen e Kryetarit të Komunës për marrjen e vendimeve që lidhen me zhvillimin e banimit dhe programet lokale që mbështesin fushën e banimit.

TRANSPARENCA DHE PËRFSHIRJA E PUBLIKUT

Qytetarët kanë të drejtën të informohen rreth mënyrës sesi shpenzohet buxheti i komunës duke përfshirë fushën e programeve tre vjeçare në veçanti. Këto të dhëna do të sigurohen duke përfshirë publikun në procesin e sigurimit të transparencës si:

- zhvillimin e takimeve konsultuese me publikun
- bërja e anketimeve apo studimeve të ndryshme për marrjen e mendimit të publikut;
- bërjen publike të programeve dhe projekteve që përfshijnë ato
- sigurimit të pjesëmarrjes së publikut gjatë diskutimeve që organet përkatëse do të zhvillojnë për hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve
- bërjen e njoftimeve të ndryshme në mjetet e informimit publik apo në vendnjoftimet komunale për aktivitetet ku mund të sigurohet pjesëmarrja e publikut
- çdo masë tjetër e cila vlerësohet e nevojshme në përmbushje të këtij qëllimi

ÇËSHTJET E TJERA

Gjatë hartimit të Programit Trevjeçar të Banimit janë marrë parasysh këto standarde:

- Realizueshmëria;
- Qëndrueshmëria;
- Efektshmëria;
- Mjaftueshmëria e kapaciteteve njerëzore dhe materiale;

- Respektimi i ligjit;
- Barazia;
- Ndikimi në mjedis dhe energjia e pastër;
- Normat e banimit;
- Ndërthurja e këtyre programeve me politikat qendrore të banimit;
- Transparenca;
- Standarde të tjera.

SWOT ANALIZA

PËRPARËSITË	DOBËSITË
-------------	----------

• Themelimi i Njësitit për Implementimin e Projektit(NJIP); • Projektet nga Qeveria dhe gadishmëria nga Komuna e Podujevës për përmirësimin e kushteve të banimit për grupet e caktuara; • Ekzistimi i dokumenteve të planifikimit hapësinor • Ekzistimi i iniciativave për PPP në fushën e ndërtimeve-banimit; • Infrastruktura në zonat urbane; • Nevoja për zona të reja të banimit; • Ekzistimi i zonave të planifikuara për banim; • Ligjet nga fusha e banimit; • Burimet njerëzore, autoritetet; komunale të përkushtuara për kategoritë e rrezikuara; • Rexhistrimi i popullsisë; • Mbulueshmëria me infrastrukturë; • Strategjitë komunale; • Interesimi i qytetarëve për pjesëmarrje në këto programe.	• Parcela të vogla ose mungesë pronë; • Kosto e lartë e pajisjes me infrastrukturë adekuate; • Kosto e lartë e banimit; • Kapacitete jo të mjaftueshme komunale për zhvillimin e banimit social; • Nuk ka programe të mjaftueshme që ndërmerren për kategoritë e caktuara; • Pronësia e pa definuar; • Mungesa e sektorit për banim pranë DSHMS.
MUNDËSITË	RREZIQET
• Ligjet dhe Programet komunale për banim; • Strategjitë shtetërore dhe qendrore; • Formimi i sektorit për banim; • Programet në nivel qendror në mbështetje në nivel lokal nga fusha e ndërtimit/banimit; • Ligjet përkatëse të inkurajojnë zhvillimin e banimi ; • Mbështetje për ndërtimet në pronësi private; • Programe mbështetëse nga partner kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushën e banimit.	• Problemet e vazhdueshme ekonomike dhe financiare; • Mungesa e fondeve në nivel lokal; • Trendi i rritjes së numrit të popullsisë në zonat urbane në raport me planet financiare dhe materiale në fushën e ndërtimit; • Papunësia dhe mungesa e punësimit; • Niveli i lartë i varfërisë.

PËRFUNDIMI

Nevoja për hartimin dhe zbatimin e Planit për banim sipas programeve të veçanta kërkon koordinimin e aktiviteteve të gjithë akterëve në kuadër të Komunës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara.

Në këtë drejtim është i nevojshëm formimi i Sektorit për Banim si organi përgjegjës, që në mënyrë aktive të zhvillojë procesin e zbatimit të aktiviteteve sipas këtij Plani. Ndërtimi i njësive të reja të banimit sipas standardeve përmes fondeve nga buxheti komunal, Qeverisë dhe Partneriteti Publik - Privat, që do të siguroj banimin për grupe të caktuara.

Përmirësimi i kualitetit të banimit duke pasur parasysh objektet ekzistuese të banimit kolektiv që në një masë sektori i banimit do të ndikojë në ngritjen e vetëdijes dhe motivimin e pronarëve të njësive të banimit si domosdoshmëri e organizimit dhe menaxhimit.

BURIMI I TË DHËNAVE

- 1.Udhëzuesi për hartimin e programeve komunale trevejçare të banimit;
- 2.Statuti i Komunës së Podujevës;
- 3.Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Podujevës;
- 4.Raportet e Agjensionit të Statistikave të Republikës së Kosovës;
- 5.Raportet e punës së Drejtorive.